



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
LUSHNJË

Nr. 1876 Prot

Lushnjë, më 05.12.2023.

Lënda: Informacion mbi procedurën e verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga kandidatet nga shpallja për konkurim për 1 (një) vend vakant, në pozicionin “*Nëpunës civil gjyqësor pranë Zyrës së Shërbimit Vlorë*”, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.

Drejtuar: Këshillit të Lartë Gjyqësor.
Këshillit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Bazuar në Ligjin 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit Nr. 622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021, me anë të cilit janë përcaktuar rregulla të hollësishme për procedurën e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor, shpalljes Nr. 1460 Prot, datë 16.11.2023, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, ju njoftoj:

Në përfundim të verifikimit paraprak, për përmbushjen e kriterëve, në lidhje me procedurën e lëvizjes paralele në pozicionin e shpallur të lirë, “*Nëpunës civil gjyqësor pranë Zyrës së Shërbimit Vlorë*”, u paraqit një(1) kandidat.

Në përmbushje të detyrave të mia si kancelar, pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar deri sot, datë 05.12.2023, ju bëj me dije se:

Në datën 01.12.2023, ishte afati i fundit i dorëzimit të dokumentave për Lëvizjen Paralele, ku rezultoi se paraqiti dokumentat 1(një) kandidate :

1)Kandidate Brunilda Alikaj.

Znj Brunilda Alikaj aktualisht ushtron detyrën e sekretares gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë prej një viti e një muaj(nëpunës gjyqësor civil i konfirmuar) Kandidatja plotëson kriteret e përgjithshme dhe të vecanta për kualifikim.

Sa më sipër bazuar ne nenin 11 të Vendimit të KLGJ-së nr. 622 datë 10.12.2020 “ Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, kandidatet:

1. Znj Brunilda Alikaj

kalon në fazën e vlerësimit profesional nga Këshilli i Gjykatës për pozicionin e lirë “Nëpunës civil gjyqësor pranë Zyrës së Shërbimit Vlorë” .

**KANCELARE
ALMA JANO**

